



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË KREDIVE**

**AGJENCIA E TRAJTIMIT
TË KREDIVE**

**ZYRA QENDROR E REGJISTRIMIT
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Nr. 2177 prot. datë 30.03.2018.

Rr "Dora D'Istria", Ndërtesa 22, Tiranë

Nr. 3196 prot. datë 30.03.2018.

Rr "Jordan Misja", Hyrja 1, Tiranë

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET ATK DHE ZQRPP**

Bazuar në Ligjin nr. 8894, datë 14.05.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", ndryshuar me ligjin nr. 9731 datë 10.05.2007 "Për disa shtesa dhe ndryshime" dhe Ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar

"Palët", Agjencia e Trajtimit të Kredive, dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bien dakort të forcojnë bashkëpunimin dhe zhvillojnë marrëdhëniet ndërmjet institucioneve si me poshtë:

**Neni I
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshje është përcaktimi i rregullave të hollësishme për bashkërendimin e punës ndërmjet Agjencisë së Trajtimit të Kredive dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të thjeshtimit të procedurave që do të zbatohen për efekt të shkëmbimit të informacionit dhe marrjes së dokumentacionit pranë ZVRPP-ve të të gjitha rretheve.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet me synimin për të rritur dhe forcuar bashkëpunimin institucional ndërmjet institucioneve të ngarkuara me ligj për të realizuar detyrimet përkatëse.

Neni 2 **Përkufizime**

Në këtë Marrëveshje termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. ATK", Agjencia e Trajtimit të Kredive.
2. "ZQRPP", Zyra Qëndrore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
3. "ZVRPP", Zyra Vendore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Neni 3 **Objekti**

1. Palët do të bashkëpunojnë për:
 - a) shkëmbimin e informacionit;
 - b) marrja e dokumentacionit ligjor duke i dërguar ZVRPP-ve të dhënat e pasurisë me shkresë zyrtare (e cila do të konsiderohet si aplikim);
 - c) ZVRPP-të përkatëse dërgojnë dokumentacionin ligjor të kërkuar nga ATK brenda afteve ligjore;
 - d) ATK-ja të dërgoj pranë ZVRPP nëpërmjet shërbimit postar dokumentacionin me të dhënat e pasurive;
 - e) ZVRPP-të i dërgojnë ATK informacionin e kërkuar brenda afateve ligjore gjithashtu nëpërmjet shërbimit postar;
 - f) Tarifa e shërbimit postar do të paguhet nga ATK.
2. Palët do të bashkëpunojnë ndërmjet tyre për mbledhjen, zhvillimin dhe analizimin e informacionit që do të shkëmbejnë në funksion të realizimit të qëllimit të ligjit.
3. Palët angazhohen të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

Neni 4 **Detyrimet e Palëve**

ATK

- ATK me shkresë zyrtare kërkon pranë ZVRPP informacion dhe dokumentacion mbi pasuritë e paluajtshme të regjistruara në emër të subjekteve debitor.
- Shkresa me anë të së cilës ATK kërkon nga ZVRPP vendosjen e bllokimit mbi pasuritë e subjekteve debitor, duhet të përmbajë të dhënat e pasurisë së subjektit përkatës mbi të cilën do të vendoset bllokimi për llogari të ATK.

ZRPP

- ZVRPP në bazë të kërkesës me shkrim të ATK jep informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar mbi pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë regjistrit që administron brenda afateve ligjore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar dhe Ligjit nr.8894, datë 14.05.2002 "Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive", i ndryshuar.
- ZVRPP në bazë të kërkesës me shkrim të bërë nga ATK për bllokimin e pasurisë së debitorit përkatës për llogari të saj, bën shënimet përkatës në regjistrin e pasurive të paluajtshme dhe brenda afatit 5 ditor nga administrimi i shkresës njofton me shkresë zyrtare ATK për veprimin e kryer.
- ZRPP garanton dhënien e informacionit sipas të dhënave të administruara nëpërmjet bazës së të dhënave të krijuara pranë saj elektronikisht dhe arkivës manuale.

Të përbashkëta

- Shkëmbimi i informacionit dhe dokumentacionit ndërmjet ATK dhe ZVRPP në funksion të përmbushjes së qëllimit të ligjit është i përjashtuar nga taksat dhe tarifat.
- Palët do të mbështesin trajnimet dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale në funksion të shërbimit për marrjen e informacionit.
- Palët do të organizojnë takime me qëllim analizimin dhe bashkërendimin e veprimeve për çështje konkrete.
- Palët gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre respektojnë të drejtat e subjekteve të të dhënave personale, në përputhje me përcaktimet e

parashikuara në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, deri në masën që nuk çënohen përgjegjësitë e tyre.

- Palët e kësaj marrëveshje të dhënat dhe informacionin e grumbulluar nuk do ta përdorin për qëllime të tjera përveç atyre të përcaktuara në ligj, në funksion të përmbushjes së detyrimeve përkatëse.

Neni 5

Bashkërendimi i punëve ndërmjet palëve

1. Drejtuesit e dy institucioneve do të angazhohen maksimalisht për zbatimin dhe respektimin e kësaj marrëveshje dhe në rast se është e nevojshme do të zhvillojnë edhe takime ndërmjet tyre apo persona të tjerë përfaqësues të ngarkuar prej tyre, në funksion të realizimit të përcaktimeve të bëra në këtë akt marrëveshje.
2. Shkëmbimi i informacionit dhe të dhënave do të bëhet në formë shkresore, por në çdo rast në rrugë zyrtare përmes shërbimit postar.
3. Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e dy institucioneve lidhur me problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje.

Neni 6

Dispozitat e fundit

1. ATK dhe ZRPP do të bashkëpunojnë për zbatimin me korrektesi të kësaj marrëveshje.
2. Secila Palë merr përsipër njohjen me detyrimet e Marrëveshjes, si dhe respektimin e zbatimit e detyrimeve që rrjedhin prej saj.
3. Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin nga Palët dhe mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.
4. Kur njëra palë kërkon të ndërpresë bashkëpunimin, sipas kësaj marrëveshje, duhet të njoftojë paraprakisht me shkrim palën tjetër 30 (tridhjetë) ditë përpara.
5. Marrëveshja hartohet në gjuhën shqipe përgatitet dhe nënshkruhet në katër kopje origjinale, dy kopje depozitohen në ZQRPP dhe dy kopje në ATK.

Neni 8

Amendimet e Marrëveshjes

Marrëveshja mund të ndryshohet me shkrim në çdo kohë me aprovimin e përbashkët të dy palëve.

PËR

AGJENCIA E TRAJTIMIT
TË KREDIVE

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Eri KOSHAJ



A handwritten signature in blue ink, located to the right of the official stamp.

PËR

ZYRA QENDROR E REGJISTRIMIT
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

KRYEREGJISTRUESI

Elion SEMANAJ

